UNIVERSITETI ISA BOLETINI MITROVICË
REKTORATI
Pranuar me dt. 17.11.2026
Nr.sisë Orga | Num 2879 | Nr.Ekzem | Vlera

UNIVERSITETI - UNIVERSITY
"ISA BOLETINI"
MITROVICË

Vazhdim i afatit të aplikimit
Thirrje publike për dhënien me qira të hapësirës së bufesë në UIBM

Në bazë të Statutit të Universitetit "Isa Boletini" në Mitrovicë, vendimit me nr. prot.1546 dt.24.06.2026 të Këshillit Drejtues të UIBM-së, vendimit me nr. prot. 2611 të Sekretarit të Përgjithshëm, komisioni vlerësues fton operatorët ekonomikë të interesuar të paraqesin oferta për marrjen me qira dhe menaxhimin e hapësirës së bufesë brenda kampusit universitar, për ofrimin e ushqimit dhe pijeve për studentët, stafin akademik dhe administrativ.

Hapësira që ipet me qira

Hapësira përfshin 163,5 m² sipërfaqe të brendshme dhe 500 m² sipërfaqe të jashtme. Hapësira e destinuar ka furnizim me ujë, energji elektrike, kanalizim dhe ventilim për kuzhinë.

Sqarimet dhe vizita e hapësirës së paraparë të ipet me qera do të mund të realizohet me datë: 24.11.2026 nga ora 10:00 deri në ora 12:00.

Kohëzgjatja dhe funksionalizimi

Kohëzgjatja e marrëveshjes do të jetë pesë (5) vite, me mundësi vazhdimi sipas kushteve të përcaktuara në marrëveshje dhe vendimmarrjes përkatëse të UIBM-së.

Operatorit të përzgjedhur i jepet afat prej (60 ditë pune) nga nënshkrimi i marrëveshjes për funksionalizimin e bufesë.

Qiraja dhe shpenzimet e shfrytëzimit

Vlera e qirasë do të kthehet në shërbime të ushqimit dhe pijeve për aktivitetet e UIBM-së. Shpenzimet e energjisë elektrike dhe ujit, të matura çdo muaj përmes matësve të brendshëm, do të përfshihen në llogaritjen e përgjithshme mujore të qirasë sipas mekanizmit të përcaktuar në marrëveshje.

Kushtet e pjesëmarrjes dhe dokumentet e ofertës

Operatorët ekonomikë paraqesin dokumentacionin administrativ, ofertën e qirasë dhe ofertën e çmimeve sipas menysë së propozuar nga UIBM.

Dokumentet për aplikim:

- Formulari i aplikimit
- Përshkrimi i çmimeve të ofruara për ushqimet dhe pijet në tabelën e menysë.
- Certifikatën e regjistrimit të biznesit me të dhënat për veprimtarinë përkatëse.
- Vërtetim nga ATK lidhur me përmbushjen e obligimeve tatimore.
- OE duhet të kenë përvojë 3 vjeçare ne lëmin e menaxhimit te bufes, restauronte, lokale apo të ngjashme (të dëshmohet me pasqyrat e deklarimit në ATK).
- Deklaratën nën betim e nënshkruar për pranimin e kushteve të thirrjes dhe përgjegjësive për higjienën, sigurinë ushqimore dhe mirëmbajtjen.

Vlerësimi i ofertave

Vlerësimi zhvillohet në dy faza:

1. Verifikimi i përmbushjes së kritereve administrative dhe
2. Vlerësimi me pikë i ofertave që i plotësojnë këto kritere.

Totali maksimal i vlerësimit është 100 pikë:

- Çmimi i qirasë — 20 pikë (qiraja e ofruar / qiraja më e lartë e pranueshme) × 20
- Kostoja e ushqimit sipas listës së çmimeve — 80 pikë (çmimi më i ulët sipas listës se menysë / çmimi i ofertuesit) × 80.

Çmimet për studentët, stafin akademik dhe administrativ paraqiten si çmime përfundimtare, me tatimet e aplikueshme të përfshirą.

Lista e çmimeve është lista e menysë bazë që do të ofrohet në bufe dhe çmimet nuk mund të ndryshohen pa aprovim nga UIBM. Çmimet e ofruar me 0 (zero) tek lista e çmimeve, konsiderohen diskualifikim gjatë përzgjedhjes. OE obligohet ti shërbej të gjitha ushqimet dhe pijet e listuara në listën e menysë.

Përzgjedhja bëhet sipas totalit më të lartë të pikëve.

Detyrimet e operatorit të përzgjedhur

- Të pajisë dhe inventarizojë hapësirën për shërbim cilësor, pa ndryshuar strukturën e objektit dhe pamjen e jashtme.

- Të investojë në vendosjen e matësve të brendshëm për ujë dhe energji elektrike, nën monitorimin e personave përgjegjës të UIBM-së.
- Të ofrojë shërbim nga e hëna deri të shtunën, në orarin 07:00–17:00. Të dielave dhe gjatë festave zyrtare, bufeja qëndron e mbyllur.
- Të organizojë shërbimin me vetëshërbim (self-service) ose në formë të kombinuar.
- Të mbajë përgjegjësi për higjienën dhe sigurinë ushqimore dhe të kryejë vlerësimet e nevojshme për operim.
- Të mbajë pastër hapësirat e brendshme dhe të jashtme në shfrytëzim dhe të lidhë marrëveshje me ndërmarrjen publike lokale për shërbimin e mbeturinave.
- Të zbatojë ndalimin e pirjes së duhanit dhe të pijeve alkoolike në hapësirat e bufesë, si dhe të mos ofrojë ushqime ose pije të ndaluara në Kosovë.
- Të zbatojë çmimet e ofertës si çmime bazë. Ndryshimi i tyre lejohet vetëm me miratimin paraprak të UIBM-së dhe mbi rrethana të arsyetuara.

Komisioni përgjegjës i UIBM-së monitoron zbatimin e përpiktë të marrëveshjes gjatë tërë periudhës së funksionimit të bufesë.

Dorëzimi dhe hapja publike e ofertave

Operatorët ofertues duhet ti sjellin ofertat e tyre **vetëm në formë fizike** me data: **30.11.2026**, ora **10:00** dhe hapja e ofertave do të bëhet në mënyrë transparente dhe publike, në Amfiteatrin e Rektoratit me prezencën e të gjithë përfaqësuesve të operatorëve që kanë ofertuar.

Oferta duhet të jetë e mbyllur në zarf dhe duhet të identifikohet me shënimin "Ofertë për marrjen me qira dhe menaxhimin e bufesë së UIBM-së", emrin e operatorit ekonomik dhe të dhënat e kontaktit.

